



REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
Rruga "Dëshmorët e Gollakut", p.n, Hajvali - Prishtinë



Referencë: **IPK/29122025/DI**
Datë: **29.12.2025**

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 21/2015 për Inspektime në Policinë e Kosovës, Rregulloren (ZKM) nr. 03/2025 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin Policor të Kosovës, Udhëzuesin për Procedurën e Planifikimit, Inspektimit dhe Raportimit, Departamenti i Inspektimit nxjerrë këtë:

RAPORT INSPEKTIMI

Objekti	- Menaxhimi i Qendrës së Ndalimit në Stacionin Policor të Podujevës
Arsyet e inicimit	- Me datë 17.11.2025, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK, z. Kushtrim Hodaj ka kërkuar zhvillimin e inspektimit të jashtëzakonshëm në Stacionin Policor të Podujevës, për të vlerësuar kushtet fizike, teknike dhe të sigurisë në Qendër të Ndalimit, si dhe zbatimin e procedurave gjatë trajtimit të të ndaluarve. Inspektimi ka ofruar mundësi për t'u njohur me kapacitetet njerëzore dhe teknike për të kryer detyrat në kuadër të përgjegjësisë, trajtimin e të ndaluarve, respektimin e të drejtave të tyre, si dhe kushtet nën të cilat trajtohen ata. Inspektimi i kontribuon ngritjes së vetëdijes së personelit për respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, krijimit të një mjedisi më të sigurtë për të ndaluarit bazuar në kriteret - standardet minimale ndërkombëtare dhe respektimin e rregullave dhe parimeve për trajtimin njerëzor dhe me dinjitet të të ndaluarve.
Objektivat	- Vlerësimi i trajtimit të të ndaluarve dhe respektimit të të drejtave të tyre, - Vlerësimi i kushteve fizike dhe të sigurisë në Qendër të Ndalimit, - Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore, profesionale dhe teknike, - Vlerësimi i administrimit të dosjeve të të ndaluarve.
Metodologjia	- Gjatë realizimit të punës inspektuese, është përdorë metodologjia si në vijim: (a) Janë realizuar takime me drejtues dhe bartës të funksioneve, si në vijim: - Komandantin e Stacionit, - Mbikëqyrësin e Qendrës së Ndalimit. (b) Janë kryer kontrolle (këqyrje, apo verifikime) të: - Kushteve fizike dhe të sigurisë në Qendër të Ndalimit, - Dosjeve të të ndaluarve; (c) Janë marrë dokumente fizike, si: - Dhjetë (10) dosje të të ndaluarve, - Vendimet mbi sistemin e personelit të Qendrës së Ndalimit, - Dëshmi mbi trajnimet nga fusha e trajtimit të të ndaluarve.
Subjekti	- Qendra e Ndalimit - Stacioni Policor në Podujevë
Afatet	- Inspektimi ka filluar më 24.11.2025 dhe ka përfunduar në po të njëjtën ditë.
Kriteri i vlerësimit	- Kodi Nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, - Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, - Procedura Standarde e Operimit - Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës.
Përgatitur nga	- Servet Tasholli, inspektor
Dorëzuar nga	- Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miratuar nga	- Kushtrim Hodaj, Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës
Datë	- 29.12.2025

Gjetjet	1. Burimet njerëzore dhe trajnimet 1.1. Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore, të cilat posedojnë Qendra të Ndalimit në zonat e tyre të përgjegjësisë, obligohen që të caktojnë personel të mjaftueshëm për organizimin dhe funksionimin me sukses të tyre, gjithnjë duke pasur parasysh nevojat, kapacitetet, kërkesat dhe numrin e të ndaluarve. Stacioni Policor - Podujevë parashihet me Strukturë organizative të ketë Qendrën e Mbajtjes, që sipas Listës së Personelit të Autorizuar duhet të ketë një mbikëqyrës me gradë të rreshterit dhe Ekipin për siguri në Gjykatë/Ndërlidhës me Gjykatat në përbërje prej dy (2) policëve. Bazuar në vendimet për sistemimin e punonjësve, Stacioni tashmë ka dy (2) policë të sistemuar në këtë Qendër, kurse ka edhe rreshterin, i cili përkundër që mbikëqyrë punën në Qendër, ende figuron si Zyrtar në Qendrën e Mbajtjes¹. Dihet se në Qendër të Ndalimit angazhohet edhe një numër i konsideruar i personelit të uniformuar. 1.2. Sipas Procedurave Standarde të Operimit, parashihet që personeli i angazhuar në Qendër të Ndalimit duhet të jetë i trajnuar. Ky dokument obligon çdo drejtori rajonale policore të aplikojë mënyrën e përzgjedhjes, trajnimit, si dhe aftësimin profesional të zyrtarëve policor, të cilët menaxhojnë dhe operojnë në Qendra të Ndalimit². IPK ka siguruar dëshmi për trajnimin e personelit të angazhuar në Qendrën e Ndalimit, të njohur si kurse bazike për qendrat e ndalimit. Personeli i Qendrës së Ndalimit po ashtu ka ndjekur edhe kurse tjera sa i përket të respektimit të të drejtave të njeriut. 1.3. Duke ditur se në Qendrën e Ndalimit angazhohen edhe zyrtarë tjerë policor gjatë ndërrimeve, IPK ka verifikuar edhe Regjistrin e pranimit - dorëzimit të detyrës, për t'u njohur me pjesën tjetër të personelit të uniformuar, nëse të njëjtit kanë ndjekur trajnime përkatëse. Sipas Regjistrit, vetëm në muajin e fundit janë angazhuar në këtë Qendër, nëntë (9) zyrtarë policor pa trajnime themelore për Qendrat e ndalimit. 2. Kushtet fizike dhe të sigurisë në Qendër të Ndalimit 2.1. Mbajtja e të ndaluarve në Qendra të Ndalimit duhet bërë kur kërkohet nga organet e rendit, me kusht që ato t'i plotësojnë standardet minimale për trajtimin dinjitoz të të ndaluarve. Të drejtat e të ndaluarve nga Policia janë të përcaktuara dhe garantuara me Kushtetutë, Kodin e Procedurës Penale dhe instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutë. Qendra e Ndalimit në Podujevë është vendosur në një aneks të Stacionit Policor. Projekti është financuar nga Qeveria Italiane dhe është realizuar nga United Nations Office for Project Services (UNOPS), në kuadër të ndërtimit, rehabilitimit dhe përshtatjes së ambienteve të qendrave të ndalimit në 21 stacione, të shpërndara në 20 komuna të vendit. Kushtet fizike dhe të sigurisë në këtë Qendër janë si vijon: (a) Dhomat e ndalimit Procedura Standarde e Operimit sa i përket standardeve minimale parasheh që Dhomat në Qendrat e Ndalimit të destinuara për përdorim të vetëm (njëshe) për qëndrime disa orëshe duhet të kenë të paktën 7 m² hapësirë banimi dhe 2.5 m lartësi, derisa për dhoma me më shumë të ndaluar, duhet të kenë të paktën 4 m² për një (1) person dhe 8 m² për dy (2) persona. Qendra ka dy (2) dhoma me nga dy (2) shtretër dhe një (1) dhomë me një (1) shtrat, që plotësojnë standardet e përcaktuara. Dhomat janë funksionale, me dyer të sigurta dhe dritare të siguruar me rrjetë metalike. Edhe pse objekti është një katësh, ka edhe daljen emergjente. (b) Dhoma për komunikim me avokatin Sipas standardeve, personi i arrestuar apo i ndaluar në Qendrën e Ndalimit ka të drejtë në komunikim konfidencial me avokatin e tij, në mënyrë verbale dhe të shkruar. Komunikimi ndërmjet të ndaluarit dhe avokatit mund të vëzhgohet, por jo edhe të dëgjohet nga zyrtari policor. Lidhur me këtë, duhet cekur se Qendra e Ndalimit në Podujevë ka kthinën për komunikim me avokatin.
---------	--

¹ Drejtoria e Personelit, *Vendim për emërim në pozitë*, nr. 07/1-01A/6311, datë 08.09.2015.

² Kapitulli B, pika 5 e Procedurës Standarde të Operimit - Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës.

(c) Mbrojtja nga zjarri

Procedura Standarde e Operimit parashih që secila Qendër e Ndalimit duhet të ketë aparatin kundër zjarrit, të ekspozuar në një vend të dukshëm. IPK ka hasur aparatin e tillë, i cili ishte i testuar dhe me afat të përdorimit deri në Prill (2026).

(d) Ndriçimi dhe ajrosja

Standardet parashohin që të gjitha dhomat në qendrat e ndalimit të kenë ndriçim të duhur (të mjaftueshëm sa për të lexuar, pa përjashtuar periudhat e gjumit) dhe ajrosje/ventilim, mundësisht dhomat duhet të kenë dritë natyrale. IPK ka vërejtur se dhomat në këtë Qendër janë mjaftueshëm të ndriçuara natyralisht dhe artificialisht, kurse sa i përket ajrosjes apo ventilimit, njëra prej tre dhomave nuk ka ajrosje të mjaftueshme. Kjo Qendër nuk ka shenja të lagështisë, sepse dyshemeja e saj mbahet ngrohtë nga sistemi i instaluar i ngrohjes qendrore.

(e) Tualetet dhe uji

Standardet parashohin që të ndaluarve duhet t'u sigurohen kushte dhe pastërti higjienike për kryerjen e nevojave fiziologjike. Standardi përcakton që tualetet në dhomat e ndalimit ku mbahen më shumë se një person, duhet të kenë ndarje fizike, që të sigurojnë privatësi. Përmes ndarjeve synohet të ruhet privatësia e të ndaluarve kur e përdorin tualetin, apo kur pastrohen. Inspektimi pasqyron se dhomat me nga dy (2) shtretër kanë ndarjet fizike të tualeteve brenda tyre, derisa dhoma njëshe nuk ka nevojë për ndarje. Dhomave dyshe u sigurohet uji për tualete nga korridori, ku janë edhe pajisjet e ujit. Dhoma njëshe nuk ka tualet.

(f) Kthina e kujdestarisë

Në drejtim të ngritjes së nivelit të sigurisë, parashihet që Qendra e Ndalimit të ketë edhe hapësirë për personelin, i cili duhet kujdesur për të ndaluarit. Në rastet kur ky staf nuk ndodhet në afërsi me dhomat e ndalimit, preferohet të instalohet sistemi i thirrjes me zile për të ndaluarit, për të mundësuar kontaktin me stafin kurdo që nevojitet. Qendra e Ndalimit edhe pse ka kthinën ku vendoset zyrtari kujdestar i Qendrës, megjithatë ka të instaluar edhe sistemin e thirrjes me zile.

(g) Monitorimi

Standardet parashohin që çdo zyrtar policor në Qendër Ndalimi është i obliguar që përmes kamerave, po ashtu dhe në mënyrë vizuale të monitorojë dhe kujdeset për sjelljet e të ndaluarit e posaçërisht kur vëren shqetësime që i paraqiten atij. Monitorimi përmes video kamerave duhet të bëhet nga një dhomë e caktuar nga zyrtarët e caktuar dhe ngjarjet duhet të regjistrohen dhe të ruhen sipas kohës së paraparë me ligj. Qendra e Ndalimit ka të instaluar dy (2) kamera në korridor dhe tre (3) të tjera brenda dhomave të ndalimit, që janë hasur funksionale, rrezja e të cilave mbulon tërë hapësirën. Materialet e deponuara ruhen tek mbikëqyrësi dhe në kthinën e zyrtarit kujdestar të kësaj Qendre.

(h) Prona personale

Rregullat parashohin që prona personale e të ndaluarve duhet menaxhuar me kujdes dhe gjësendet e tyre duhet të vendosen në paketime, të regjistrohen në formë përkatëse dhe të vendosen në një pliko/qese letre të mbyllur, që duhet ruajtur në sirtar të mbyllur me çelës. Qendra e Ndalimit ka sirtarin metalik të siguruar me çelës, brenda të cilit ruhen pronat e të ndaluarve. IPK ka verifikuar të dhënat brenda formularit të pronës dhe ka vërejtur se lidhëset e këpucëve dhe pajisjet tjera personale, që mund të shërbejnë për vet-lëndim, janë të regjistruar, duke mos iu lënë në dispozicion të ndaluarve gjatë fazës së ndalimit.

(i) Kushtet higjienike

Sipas procedurës Standarde të Operimit, të gjitha dhomat në Qendrat e Ndalimit duhet të jenë të pastra dhe personat që duhet të kalojnë natën aty, duhet të pajisen me dyshekë dhe batanije të pastra. IPK ka parë nga afër dyshekë dhe mbulesa (batanije) të pastra dhe për pastrimin e këtyre të fundit tanimë kujdeset një kompani e kontraktuar nga Policia e Kosovës (Eco Clean Corporation). Sa i përket hapësirave të brendshme të Qendrës, në kohën e inspektimit ato kanë

qenë duke u pastruar nga shërbimi i pastrimit. Në hapësirat e brendshme nuk janë hasur shenja të konsumimit të duhanit.

(j) Masat ndaj vet-lëndimeve

Standardet përcaktojnë që është rreptësisht e ndaluar që në të gjithë hapësirën e Qendrave të Ndalimit të mbahen pajisje, që mund të jenë: shkopinj druri, fshesë, shkop bejsbolli, shufra hekuri, pjesë të kablove, armë irrituese dhe thika të ndryshme, apo çfarëdo mjeti që mund të shërbejë për kërcënim, apo lëndim të të ndaluarve. IPK nuk ka hasur mjete të tilla të rrezikshme brenda hapësirave të Qendrës së Ndalimit.

3. Kushtet materiale dhe higjienike në Qendër të Ndalimit

3.1. Përveç kushteve fizike dhe të sigurisë, IPK ka verifikuar përmbushjen edhe të disa prej kushteve materiale për punë dhe atyre higjienike brenda Qendrës. Nga verifikimi i kryer, IPK jep këtë pasqyrë për secilën prej tyre:

(a) Inventari dhe pajisjet

Sipas standardeve, Qendra e Ndalimit nevojitet të ofrojë kushte pune për zyrtarë që punojnë. Sipas inspektimit, Qendra e Ndalimit ka kthinën e veçantë brenda saj, ku angazhohet zyrtari kujdestar, që ka në dispozicion pajisjet dhe inventarin e nevojshëm të punës (kompjuter, printer, tavolinë, karrike, dollap pune).

(b) Ndihma e parë

Standardet në fuqi përcaktojnë që Qendra e Ndalimit duhet të posedojë pajisjen e ndihmës së parë dhe pajisjet tjera shtesë, të nevojshme për t'iu ofruar ndihmë personave në raste emergjente. Zyrtari kujdestar në këtë Qendër ka prezantuar kutinë e ndihmës së parë.

(c) Materialet higjienike

Standardet në fuqi përcaktojnë që stafi që punon në Qendër të Ndalimit duhet të pajiset me mjete të nevojshme për mbrojtje nga infektimi i mundshëm gjatë kontaktit me gjak, apo me lëngje trupore. Personeli kujdestar i kësaj Qendre ka prezantuar kontigjentët e dorëzave dhe materialeve tjera higjienike.

(d) Librat e evidencës

Secila Qendër Ndalimi duhet të sigurojë në format A-3, Librin për evidentimin e të ndaluarve, Librin për evidentimin e vizitorëve, ekipeve monitoruese që kanë për qëllim hyrjen në Qendër të Ndalimit, si dhe Librin për pranimin - dorëzimin e detyrës nga zyrtarët policor. Mbikëqyrësi i Qendrës së Ndalimit ka prezantuar të tria Librat e evidencës.

(e) Kujdesi ndaj dosjeve

Dosjet e ndalimit të mbajtura në Qendrat e Ndalimit ruhen në Polici deri në 10 vjet nga koha e përfundimit zyrtar të procedurës penale, ose nga lirimi i personit të ndaluar³. Sipas rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës, çdo dosje origjinale duhet të bëhet kopje dhe të ruhet në vend të sigurt. IPK ka gjetur se dosjet origjinale të personave të ndaluar mbahen dhe në kopje në një vend të dytë. Dosjet origjinale mbahen në kthinën e zyrtarit kujdestar brenda Qendrës së Ndalimit, derisa kopja ruhet në zyrën e Mbikëqyrësit të Qendrës së Ndalimit.

(f) Formularët

Formularët brenda dosjeve sipas Procedurës Standarde të Operimit duhet të jenë të unifikuar dhe konform ekzemplarëve të publikuar në Intranet. IPK ka vërejtur se formularët që përdoren nga Qendra e Ndalimit janë sipas standardit, por se ka nevojë t'i kushtohet rëndësi më e madhe plotësimit të të gjitha të dhënave.

³ Procedura Standarde e Operimit, *Qendrat e Ndalimit në Policinë e Kosovës*, referencë DDO-04-023/2020, datë 01.10.2020.

4. Trajtimi i personave të ndaluar dhe respektimi i të drejtave të tyre

4.1. Çdo person i privuar nga liria gëzon të drejtat dhe liritë themelore të përcaktuar në Kushtetutë dhe ligje. Andaj, respektimi dhe mbrojtja e tyre është e drejtë e çdo personi, pavarësisht rrezikshmërisë së tij, apo veprës së kryer. Të ndaluarit mund të rrezikohen të jenë viktimë të torturës, keqtrajtimit, trajtimeve çnjerëzore, si dhe poshtëruese nga personeli policor, apo të ndaluarit tjerë. Përmbushja e standardeve që mundësojnë respektimin e të drejtave e lirive të të ndaluarve është detyrim i institucioneve, në këtë rast Policisë. Bazuar në ndjeshmërinë e punës në Qendra Ndalimi, sjellja e përgjegjësisia e çdo zyrtari policor nuk duhet udhëhequr nga ndjenja personale, paragjykimë, urrejtja, a lidhjet shoqërore, që mund të ndikojnë në punën, veprimet dhe vendimmarrjen e tij. IPK ka vënë theksin tek trajtimi i të ndaluarve dhe me këtë rast ka kontaktuar një të tillë të hasur në Qendër të Ndalimit. Në anën tjetër, janë inspektuar dhjetë (10) dosje të ndalimit, ku janë verifikuar veprimet në respektimin e të drejtave të të ndaluarve⁴. IPK pasqyron trajtimin e të ndaluarve si në vijim:

(a) Aktvendimi mbi ndalimin

Sipas rregullave, Policia nuk mund të privojë personin nga liria, përveç nëse arrestimi/ndalimi lejohet sipas ligjeve në fuqi. Me rastin e dyshimeve të bazuara për shkelje të ligjeve pozitive, Policia në koordinim me Prokurorin e Shtetit, personat e arrestuar/ndaluar përkohësisht i sistemon në qendra ndalimi. Me këtë rast, Prokurori lëshon Aktvendim mbi ndalimin, për të caktuar masën e ndalimit për 24/48 orë, në bazë të të cilit ata edhe pranohen në qendra të ndalimit. Kodi i Procedurës Penale në nenin 162, paragrafi 5 përcakton që sa më shpejtë që është e mundur pas arrestimit dhe jo më vonë se gjashtë (6) orë nga koha e arrestimit, Prokurori i Shtetit i lëshon personit të arrestuar, vendimin me shkrim mbi ndalimin. Inspektimi pasqyron se në të gjitha mostrat e dosjeve të ndalimit janë hasur aktvendimet mbi ndalimin, të lëshuara nga Prokurori i Shtetit. Duhet cekur se formulari përkatës brenda dosjes ka të dhënat mbi kohën e arrestimit.

(b) Garancitë kundër keqtrajtimit

Konform nenit 165 të Kodit të Procedurës Penale, personi i arrestuar gëzon disa të drejta, përfshirë dhe njoftimin mbi arsyet e arrestimit, shfrytëzimin e ndihmës së mbrojtësit që e zgjedhë vet ose t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguajë për ndihmë juridike, dhe për arrestimin e tij të lajmërojë ose të kërkojë nga policia ta lajmërojë anëtarin e familjes, ose personin tjetër sipas zgjedhjes së tij. IPK ka kontrolluar dosjet e ndalimit dhe formulari përkatës brenda tyre pasqyron se të ndaluarve në të gjitha rastet u janë lexuar të drejtat e garantuara dhe këtë ata e deklarojnë me nënshkrimet e tyre. Në 4 nga 10 raste (dosje), të ndaluarit kanë shfrytëzuar të drejtën për të pasur avokat mbrojtës dhe në 9 nga 10 raste (dosje), të ndaluarit kanë njoftuar anëtarët e familjes mbi arrestimin e tyre. Të gjitha këto dëshmohen nga formularët që gjenden brenda dosjeve.

(c) Kujdesi shëndetësor

Kodi i Procedurës Penale (neni 167) përcakton që personi i arrestuar ka të drejtë që sipas kërkesës së tij të kontrollohet nga mjeku ose dentisti sipas zgjedhjes së tij sa më shpejt që të jetë e mundur pas arrestimit dhe në çdo kohë gjatë ndalimit. IPK është interesuar të njihet nëse të ndaluarit (F.H) që është ndodhur në Qendër Ndalimi i është respektuar kjo e drejtë. I ndaluarit ka pohuar respektimin e kësaj të drejte. Ekipi i inspektimit nuk ka pranuar ankesa nga Qendra e Ndalimit për pakënaqësi eventuale nga të ndaluarit. Nga dosjet e inspektuara të ndalimit është parë se personeli kujdestar ka plotësuar formularin përkatës me njoftimin për të drejtën për të përfutur shërbime mjekësore. Në 3 nga 10 mostrat e përzgjedhura janë evidentuar shenjat e lëndimeve në formular dhe për ta është ofruar kontrolli nga mjeku kujdestar i urgjencës. Mjeku ka lëshuar dëshmi mbi kontrollin, porse

⁴ Dosjet e ndalimit të përzgjedhur me metodë rastësore: 0003/25, 0007/25, 0045/25, 0075/25, 0141/25, 0145/25, 0186/25, 0194/25, 0200/25 dhe 0203/25.

	kjo evidencë nuk është përshkruar edhe në formular brenda dosjes. Duhet cekur se disa ditë para inspektimit, IPK ka filluar një hetim lidhur me dyshimet për një keqtrajtim brenda këtij Stacionit. Departamenti i Inspektimit ka siguruar një dosje shtesë të ndalimit për t'u siguruar nëse lëndimet tek i ndaluari (B.M) janë evidentuar me rastin e vendosjes së tij në këtë Qendër. Sipas dosjes nr. 0215/25, të arrestuarit në fjalë i ishte ofruar ndihma mjekësore para dhe pas vendosjes së tij në Qendër të Ndalimit. Sipas formularit përkatës, zyrtari kujdestar i Qendrës së Ndalimit kishte evidentuar lëndimet në fytyrë tek i ndaluari. Hetimi i këtij rasti është duke u zhvilluar nga ekipi hetimor i IPK-së. (d) Ushqimi Kodi i Procedurës Penale (neni 168) përcakton që personit të ndaluar për më shumë se 12 orë i sigurohen tre (3) racione ushqimi në ditë. Kurse, personit të ndaluar në kohëzgjatje më pak se 12 orë i sigurohet një racion ushqimi për çdo katër (4) orë të ndalimit. Ekipi i inspektimit është njoftuar se Qendra e Ndalimit siguron ushqim për të ndaluarit nga një furrë e bukës (nën kontraktuar nga "Beni Dona"). I ndaluari i hasur në Qendër të Ndalimit në Podujevë ka pohuar se ka pranuar racionet sipas rregullit. Dosjet e ndalimit nuk pasqyrojnë informata mbi sigurimin e racioneve për të ndaluarit, meqë formulari përkatës nuk është hasur brenda tyre. Nga praktikat e stacioneve tjera, pjesë e dosjeve duhet të jetë edhe formulari mbi veprimet dhe ngjarjet lidhur me të ndaluarit, ku pasqyrohet mes tjerash edhe ofrimi i racioneve për të ndaluarit. (e) Lirimi i të ndaluarit Sipas rregullave të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale, koha e ndalimit policor të të dyshuarve të mundshëm në qendrat e ndalimit nuk duhet të kalojë më shumë se 48 orë nga koha e arrestimit të tij, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake urdhëron ndryshe, respektivisht sipas nenit 60 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ndalimi i të miturit nuk mund të kalojë periudhën 24 orës, pas kalimit të kësaj periudhe. Sipas formularëve të dosjeve të ndalimit në të gjitha rastet, të ndaluarit janë liruar me kohë, kurse në disa prej rasteve, organi kompetent ka lëshuar urdhëresë për lirim. Formulari përkatës brenda dosjeve të ndalimit ka të dhënat mbi kohën e lirimit të të ndaluarve.
Përfundim	Bazuar në gjetjet e inspektimit rezultojnë se: 1. Stacioni ka përmbushur strukturën me burime njerëzore sa i përket Qendrës së Mbajtjes, përveç se rreshteri në rolin e mbikëqyrësit figuron si zyrtar i Qendrës. 2. Staf i përhershëm i kësaj Qendre, si dhe një pjesë e konsideruar e personelit të uniformuar ka kryer trajnime të rëndësishme që lidhen me fushën, por janë hasur edhe zyrtarë tjerë të angazhuar në Qendër, që nuk kanë kryer trajnimet përkatëse. 3. Kushtet fizike dhe të sigurisë brenda Qendrës së Ndalimit përmbushin shumicën e standardeve minimale të kërkuara me rregullat e përcaktuara ndërkombëtare. Ka nevojë që njëra nga tre dhomat e ndalimit të përmirësojë sistemin e ajrosjes, kurse një tjetër të sigurojë tualetin brenda dhomës. 4. Prona e të ndaluarve sigurohet dhe ruhet në mënyrën e duhur. 5. Ambientet, dyshekët e mbulesat mbahen të pastra. Qendra e Ndalimit ka siguruar edhe materialet higjienike për të eliminuar infeksionet e mundshme nga kontaktet. 6. Brenda ambienteve të Qendrës së Ndalimit nuk janë hasur mjete, apo pajisje që mund të përdoren për ndonjë sulm, apo vet-lëndim. 7. Qendra e Ndalimit ka hapësirë, inventar e pajisje të mjaftueshme për menaxhimin e punëve brenda saj. Personeli menaxhues dhe kujdestar i Qendrës së Ndalimit ka në dispozicion edhe regjistrat e nevojshëm të evidencave. 8. Dosjet e ndalimit mbahen në origjinal dhe kopje, sipas afateve të ruajtjes dhe në kushte sigurie. 9. Formularët brenda dosjeve të ndalimit janë të unifikuara, por me nevojën që t'i kushohet rëndësi më e madhe plotësimit të të gjitha të dhënave brenda tyre.

	10. Aktvendimet mbi ndalimin janë hasur në të gjitha dosjet e ndalimit, kurse lirimi i të ndaluarve është bërë brenda afateve prej 24/48 orë. 11. Tre garancitë në drejtim të respektimit të të drejtave të ndaluarve, përfshirë këtu njoftimin për arsyet e arrestimit, shfrytëzimin e ndihmës së mbrojtësit (avokatit) dhe lajmërimin e anëtarit të familjes, janë marrë parasysh nga personeli i Qendrës së Ndalimit në të gjitha rastet. 12. Në rastet kur janë hasur shenja të lëndimeve, është dëshmuar prezenca e mjekut dhe ofrimi i ndihmës mjekësore. Dokumentimi i kontrolleve mjekësore nevojitet të pasqyrohet edhe përmes formularit përkatës të gjendjes shëndetësore brenda dosjes së ndalimit. 13. Ushqimi sigurohet nga një furrë buke, por që brenda dosjes mungon formulari i veprimeve dhe ngjarjeve lidhur me të ndaluarit, i cili sipas praktikave në stacionet tjera dokumenton veç tjerash edhe racionet e ushqimit për të ndaluarit.
--	--

Përmbledhja e rekomandimeve dhe Plani i Veprimit				
Nr	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK i rekomandon Komandantit të Stacionit Policor të Podujevës, që të përfshijë në trajnimet e nevojshme për qendrën e mbajtjes edhe pjesën tjetër të personelit operativ, që angazhohet si personel kujdestar në përkujdesje të të ndaluarve.	-I-	Stacioni Policor- Podujevë me prioritet do të kërkoj trajnim adekuat për zyrtarët që nuk e kanë të kryer për QM (ne kemi pasur mjaftueshëm zyrtarë me trajnim të tillë, mirëpo kanë marrë transfere në stacione tjera)	Brenda TM1 dhe TM2
2.	IPK i rekomandon Komandantit të Stacionit që bashkë me Drejtorinë e Menaxhimit të Objekteve, të kujdeset për sanimin (eliminimin) e defektit lidhur me ajrosjen (ventilimin) në njërin prej dhomave të ndalimit.	-I-	Do të adresojmë kërkesën për sanimin e QM, konkretisht në njërin nga dhomat e saj në të cilën nuk ka tualet, të shtohet tualeti dhe kërkesat për ventilim. Kërkesa për këto intervenime do të adresohet në departamentin përkatës.	Brenda TM2
3.	IPK i rekomandon Komandantit të Stacionit dhe Shefit të Sektorit të Operativës, që të ushtrojnë kontrolle në Qendrën e Ndalimit, drejt mbajtjes cilësore të evidencës në kuadër të dosjeve të ndalimit (kompletimin e dosjes dhe plotësimin e formularëve).	-I-	Të bëhen inspektime të rregullta nga Shefi i Operativës dhe nga Mbikëqyrësi i QM, duke ndërmarrë masa që të plotësohen të gjithë formularët siç kërkohet dhe në përgjithësi të respektohet PSO-ja në fuqi që parasheh detyrat dhe autorizimet që duhet të kryhen në QM.	Në vazhdimësi